LIGJ
Nr.10 092, datë 9.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA "PËR KONTRATAT PËR SHITJEN NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e Kombeve të Bashkuara "Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6102, datë 19.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA
MBI KONTRATAT PËR SHITJEN NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE.

Parathënie

Shtetet palë në këtë Konventë,

duke pasur parasysh objektivat e gjera në rezolutat e adaptuara nga sesioni special i gjashtë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi vendosjen e një rregulli të ri ekonomik ndërkombëtar,

duke konsideruar se zhvillimi i tregtisë ndërkombëtare në bazë të barazisë dhe përfitimit reciprok është një element i rëndësishëm në nxitjen e marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve,

duke qenë të mendimit se adaptimi i rregullave të njësishme, të cilat rregullojnë kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave dhe marrin parasysh sistemet e ndryshme sociale, ekonomike dhe ligjore do të kontribuonte në heqjen e barrierave ligjore në tregtinë ndërkombëtare dhe nxiste zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare,

ranë dakord si vijon:

PJESA I
FUSHA E ZBATIMIT DHE DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

KAPITULLI 1
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për kontratat e shitjes së mallrave ndërmjet palëve për të cilat vendet e biznesit janë në shtete të ndryshme:

a) kur shtetet janë shtete kontraktuese; ose

b) kur rregullat e së drejtës ndërkombëtare private kërkojnë zbatimin e ligjit të një shteti kontraktues.

2. Fakti, që palët kanë vendin e tyre të biznesit në shtete të ndryshme nuk duhet të merret parasysh kur ky fakt nuk paraqitet si nga kontrata ashtu edhe nga çdo marrëdhënie ndërmjet, apo nga informacionet e zbuluara nga palët në çdo kohë para ose gjatë lidhjes së kontratës.

3. As kombësia e palëve, as karakteri civil ose tregtar i palëve ose i kontratës nuk merret në konsideratë në përcaktimin e zbatimit të kësaj Konvente.

Neni 2

Kjo Konventë nuk zbatohet për shitjet:

a) e mallrave të blera për përdorim personal, familjar apo shtëpiak, përveç kur shitësi në çdo kohë para ose gjatë lidhjes së kontratës, nuk e dinte dhe as nuk duhet të ketë ditur se mallrat ishin blerë për njërën nga këto përdorime;

b) me ankand;

c) në ekzekutim ose në të kundërt nga autoriteti i ligjit;

d) e kapitaleve, aksioneve, letrave me vlerë të investimeve, instrumenteve të negociueshme ose para;

e) e anijeve, mjeteve lundruese, mjeteve lundruese me jastëk ajri, avionëve;

f) e energjisë elektrike.

Neni 3

1. Kontratat për furnizimin e mallrave që fabrikohen ose prodhohen duhet të konsiderohen shitje, përveç kur pala që porosit mallrat merr përsipër të furnizojë një pjesë të konsiderueshme të materialeve të nevojshme për një fabrikim apo prodhim të tillë.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet për kontratat në të cilat pjesa mbizotëruese e detyrimeve të palës e cila furnizon mallrat konsiston në furnizmin e punës apo të shërbimeve të tjera.

Neni 4

Kjo Konventë rregullon vetëm formimin e kontratës së shitjes dhe të drejtat e detyrimet e shitësit dhe blerësit që rrjedhin nga kjo kontratë. Në veçanti, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Konventë, ajo nuk ka të bëjë me:

a) vlefshmërinë e kontratës apo të ndonjë dispozite të saj apo të çdo përdorimi;

b) efektin që mund të ketë kontrata mbi pronësinë e mallrave të shitura.

Neni 5

Kjo Konventë nuk zbatohet për përgjegjësinë e shitësit për vdekjen ose dëmtimet personale të shkaktuara nga mallrat ndaj çdo personi.

Neni 6

Palët mund të përjashtojnë zbatimin e kësaj Konvente ose, sipas nenit 12, shmangin ose ndryshojnë efektin e çdonjërës prej dispozitave të saj.

KAPITULLI II
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 7

1 Në interpretimin e kësaj Konvente, vëmendje duhet t'i kushtohet karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për të nxitur standardizimin në zbatimin e saj dhe në respektimin e mirëbesimit në tregtinë ndërkombëtare.

2. Çështjet që kanë të bëjnë me problemet e rregulluara nga kjo Konventë, të cilat nuk qartësohen shprehimisht në të duhet të zgjidhen në përputhje me parimet e përgjithshme mbi të cilën ajo bazohet ose, në mungesë të këtyre parimeve, në përputhje me ligjin e zbatueshëm në bazë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 8

1. Për qëllime të kësaj Konvente deklarimet e bëra ose veprimi tjetër i një pale duhet të interpretohen sipas qëllimit të tij, kur pala tjetër e dinte ose nuk mund të mos kishte dijeni se kush ishte qëllimi.

2. Në qoftë se paragrafi i mësipërm nuk është i zbatueshëm, deklarimet e bëra dhe veprimi tjetër i një pale duhet të interpretohen në përputhje me mirëkuptimin që një person i arsyeshëm i të njëjtit lloj si pala tjetër do të kishte në të njëjtat rrethana.

3. Në përcaktimin e qëllimit të një pale ose të mirëkuptimit që një person i arsyeshëm do të kishte, konsideratë e duhur duhet t'u jepet gjithë rrethanave përkatëse të çështjes duke përfshirë negociatat, çdo praktikë të cilën palët kanë vendosur ndërmjet tyre, përdorimet ose çdo veprim vijues të palëve.

Neni 9

1. Palët lidhen nga çdo përdorim për të cilën ato kanë rënë dakord dhe nga çdo praktikë të cilën ato e kanë përcaktuar ndërmjet tyre.

2. Palët konsiderohen, përveç kur bien dakord ndryshe, të kenë bërë të zbatueshme, pa e cituar shprehimisht në konratën e tyre ose hartimin e saj, një përdorim të cilën palët e dinin ose duhej ta kishin ditur dhe i cili në tregtinë ndërkombëtare njihet gjerësisht, dhe respektohet rregullisht, nga palët për kontratat e tipit të përfshira në tregtinë e veçantë përkatëse.

Neni 10

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) në rast se një palë ka më shumë se një vend biznesi, vend i biznesit është ai, i cili lidhet më ngushtë me kontratën dhe përmbushjen e saj, duke pasur parasysh rrethanat e njohura ose të parashikuara nga palët në çdo kohë para ose gjatë lidhjes së kontratës;

b) në qoftë se një palë nuk ka një vend biznesi, për referim duhet të merret vendbanimi i tij i rregullt.

Neni 11

Një kontratë shitje nuk ka nevojë që të lidhet ose provohet me shkrim dhe nuk i nënshtrohet ndonjë kërkese tjetër në lidhje me formën. Ajo mund të provohet me çdo mjet, duke

përfshirë dëshmitarë.

Neni 12

Çdo dispozitë e nenit 11, nenit 29 ose pjesa e II-të e kësaj Konvente që lejon një kontratë shitje ose ndryshimin ose mbarimin e saj me marrëveshje ose me çdo propozim, pranim ose tregues tjetër të qëllimit, që bëhet në çdo formë tjetër përveç asaj me shkrim, nuk zbatohet aty ku çdo palë ka vendin e saj të biznesit në një shtet kontraktues, i cili ka bërë një deklaratë sipas nenit 96 të kësaj Konvente. Palët nuk mund të shmangen nga/ose ndryshojnë efektet e këtij neni.

Neni 13

Për qëllime të kësaj Konvente "shkrim" përfshin telegramin dhe teleksin.

PJESA II
HARTIMI I KONTRATËS

Neni 14

1. Një propozim për lidhjen e një kontrate, drejtuar një apo më shumë personave specifikë përbën një ofertë, në qoftë se ai është mjaft i qartë dhe tregon qëllimin e ofruesit për ta lidhur në rast pranimi. Një propozim është mjaft i qartë nëse tregon mallrat dhe shprehimisht ose tërthorazi cakton ose parashikon kushtet për përcaktimin e sasisë dhe çmimit.

2. Një propozim, tjetër nga ai i drejtuar tek një ose më shumë persona specifikë duhet të konsiderohet thjesht si ftesë për të bërë ofertën, përveç kur e kundërta tregohet qartë nga personi që bën propozimin.

Neni 15

1. Një ofertë bëhet efektive, kur ajo i dorëzohet personit që i bëhet oferta.

2. Një ofertë, edhe nëse është e parevokueshme, mund të tërhiqet në qoftë se tërheqja i dorëzohet personit që i bëhet oferta para apo në të njëtjën kohë si oferta.

Neni 16

1. Deri në lidhjen e kontratës, një ofertë mund të revokohet në rast se revokimi i dorëzohet personit që i bëhet oferta para dërgimit të një miratimi nga ana e tij.

2. Megjithatë, një ofertë nuk mund të revokohet:

a) nëse tregon, qoftë nëpërmjet deklarimit të një kohe të përcaktuar për pranim ose ndryshe, që është e parevokueshme; ose

b) nëse do ishte e arsyeshme për personin që i bëhet oferta, të bazohej te oferta si të ishte e parevokueshme dhe personi që i bëhet oferta ka vepruar në mbështetje të ofertës.

Neni 17

Një ofertë, edhe nëse është e parevokueshme, përfundon kur refuzimi i dorëzohet personit që bën ofertën.

Neni 18

1. Një deklaratë e bërë nga ose një veprim tjetër i personit që i bëhet oferta që tregon miratim ndaj ofertës është një pranim.

Heshtja ose mosveprimi nuk është baras me pranimin.

2. Një pranim i një oferte bëhet efektiv në momentin kur njoftimi i miratimit arrin te ofertuesi. Një pranim nuk është efektiv në qoftë se njoftimi i miratimit nuk arrin te ofertuesi brenda kohës që ai ka përcaktuar ose, kur koha nuk është përcaktuar, brenda një kohe të arsyeshme, ku rëndësi e veçantë i është dhënë kushteve të veprimit, duke përfshirë shpejtësinë e mjeteve të komunikimit të përdorura nga ofertuesi. Një ofertë verbale duhet të pranohet menjëherë, përveç kur rrethanat tregojnë të kundërtën.

3. Megjithatë, nëse, në bazë të ofertës apo si rezultat i praktikave të përcaktuara nga palët ndërmjet tyre apo nga përdorimi, personi që merr ofertën mund të tregojë miratim nëpërmjet kryerjes së një veprimi, si ai që lidhet me transportin e mallrave ose pagimin e çmimit, pa njoftuar ofertuesin, pranimi është efektiv në momentin kur kryhet veprimi, me kusht që veprimi të kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin e mësipërm.

Neni 19

1. Një përgjigje ndaj ofertës e cila tregon të jetë një pranim, por përfshin shtesa, kufizime ose modifikime të tjera është një refuzim i ofertës dhe përbën një kundërofertë.

2. Megjithatë, një përgjigje ndaj një oferte e cila tregon të jetë një pranim, por përmban kushte shtesë apo të ndryshme, të cilat nuk ndryshojnë materialisht kushtet e ofertës përbën një pranim, përveç kur ofertuesi, pa shumë vonesë, kundërshton gojarisht mospërputhjet ose dërgon një njoftim për këtë qëllim. Në qoftë se ai nuk kundërshton në këtë mënyrë, kushtet e kontratës janë kushtet e ofertës me modifikimet që përmban pranimi.

3. Kushtet shtesë apo të ndryshme që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me çmimin, pagesën, cilësinë dhe sasinë e mallrave, vendin dhe kohën e dorëzimit, shtrirjen e përgjegjësisë së njërës palë ndaj tjetrës ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konsiderohen se ndryshojnë materialisht kushtet e ofertës.

Neni 20

1. Një periudhë kohe për pranim, e përcaktuar nga ofertuesi në një telegram ose në një letër, fillon të ketë forcë ligjore nga momenti kur telegrami dorëzohet për t'u dërguar ose nga data e treguar në letër ose, kur nuk tregohet një datë e tillë, nga data e treguar në zarf. Një periudhë kohe për pranim, e përcaktuar nga ofertuesi me telefon, teleks ose mjete të tjera komunikimi të shpejta, fillon të ketë forcë ligjore nga momenti kur oferta i dorëzohet personit që i bëhet oferta.

2. Festat zyrtare ose ditët pushim që bien gjatë periudhës për pranim përfshihen në llogaritjen e kësaj periudhe kohe. Megjithatë, nëse njoftimi i pranimit nuk mund të dërgohet në adresën e ofertuesit në ditën e fundit të afatit, për shkak se ajo ditë është një ditë feste zyrtare ose pushimi në vendin e biznesit të ofertuesit, periudha kohore zgjatet deri në ditën e parë të punës që vijon.

Neni 21

1. Një pranim i vonshëm është prapseprapë efektiv si një pranim, në qoftë se ofertuesi, pa vonesë, informon gojarisht personin që i bëhet oferta ose dërgon një njoftim për këtë qëllim.

2. Në qoftë se një letër ose shkresë tjetër që përmban një pranim të vonshëm, tregon se është dërguar në ato rrethana që në rast se transmetimi i tij do të ishte normal, ajo do t'i dorëzohej ofertuesit në kohën e duhur, pranimi i vonshëm është efektiv si një pranim, përveç kur, pa vonesë,

ofertuesi informon gojarisht personin që i bëhet oferta, se ai e konsideron ofertën e tij si t'i ketë kaluar afati ose dërgon një njoftim për këtë qëllim.

Neni 22

Një pranim mund të tërhiqet në qoftë se tërheqja i dorëzohet ofertuesit para se apo në të njëjtën kohë, kur pranimi do të ishte bërë efektiv.

Neni 23

Një kontratë lidhet në momentin kur një pranim i një oferte bëhet efektiv në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 24

Për qëllime të kësaj pjese të Konventës, një ofertë, deklarim për pranim apo çdo tregues tjetër i qëllimit "mbërrin" te i adresuari kur i bëhet gojarisht ose i dorëzohet me çdo mjet tjetër personalisht, te vendi i tij i biznesit ose adresa postare, ose, në qoftë se nuk ka një vend biznesi ose adresë postare, te vendbanimi i tij i përhershëm.

PJESA III
SHITJA E MALLRAVE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 25

Një shkelje e kontratës e kryer nga njëra prej palëve është themelore, në qoftë se rezulton në dëm të palës tjetër kryesisht aq sa ta privojë atë nga çfarë ajo ka të drejtë të presë sipas kontratës, përveç kur pala në shkelje nuk e parashikoi dhe një person i arsyeshëm i të njëjtit lloj në të njëjtat rrethana nuk do ta kishte parashikuar një rezultat të tillë.

Neni 26

Një deklaratë për anulimin e kontratës është efektive vetëm në rast se i bëhet me shkrim palës tjetër.

Neni 27

Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Konventës, nëse çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër jepet ose bëhet nga një palë në përputhje me këtë pjesë dhe me mjete të përshtatshme me rrethanat, një vonesë ose gabim në transmetimin e komunikimit apo mosmbërritja e saj nuk e privon atë palë nga e drejta për t'u bazuar në komunikim.

Neni 28

Në qoftë se, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, njëra palë ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e ndonjë detyrimi nga pala tjetër, një gjykatë nuk është e detyruar të japë një vendim për ekzekutim të veçantë, përveç kur gjykata do të vepronte në këtë mënyrë sipas ligjit të saj në lidhje me kontrata shitjeje të ngjashme që nuk rregullohen nga kjo Konventë.

Neni 29

1. Një kontratë mund të ndryshohet ose zgjidhet thjesht me marrëveshje të palëve.

2. Një kontratë me shkrim, e cila përmban një dispozitë që kërkon çdo ndryshim ose zgjidhje me marrëveshje të jetë me shkrim, mund të mos ndryshojë ose zgjidhet në të kundërt me marrëveshje. Megjithatë, një palë mund të mos lejohet që me veprimin e saj ta konfirmojë këtë dispozitë në atë masë që pala tjetër është bazuar mbi këtë veprim.

KAPITULLI II
DETYRIMET E SHITËSIT

Neni 30

Shitësi duhet t'i dorëzojë mallrat dhe çdo dokument në lidhje me to dhe të transferojë pronësinë e mallrave, siç kërkohet nga kontrata dhe kjo Konventë.

SEKSIONI I
DOREZIMI I MALLRAVE DHE DHËNIA E DOKUMENTEVE

Neni 31

Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në ndonjë vend tjetër të veçantë, detyrimi i tij për t'i dorëzuar konsiston:

a) në dorëzimin e mallrave te transportuesi i parë për transferimin te blerësi, në qoftë se kontrata e shitjes përfshin transportimin e mallrave;

b) në venien e mallrave në dispozicion të blerësit në atë vend, në qoftë se, në rastet e papërfshira në nënparagrafin e mësipërm, kontrata ka të bëjë me mallra specifike, ose mallra të paidentifikuara për t'u marrë nga një magazinë e veçantë apo për t'u fabrikuar ose prodhuar, dhe në kohën e lidhjes së kontratës palët e dinin që mallrat ishin apo ishin për t'u fabrikuar ose prodhuar në një vend të posaçëm;

c) në raste të tjera-në vënien e mallrave në dispozicion të blerësit në vendin ku shitësi kishte vendin e tij të biznesit në kohën e lidhjes së kontratës.

Neni 32

1. Në qoftë se shitësi, në përputhje me kontratën ose këtë Konventë, i dorëzon mallrat te një transportues dhe në qoftë se mallrat nuk janë shumë të identifikuara sipas kontratës nëpërmjet shenjave dalluese mbi mallrat, nëpërmjet dokumenteve të transportit ose të tjera, shitësi duhet ta informojë blerësin mbi dërgesën duke specifikuar mallrat.

2. Në qoftë se shitësi është i detyruar që të organizojë transportimin e mallrave, ai duhet të lidhë kontrata të nevojshme për transportimin në vendin e përcaktuar me mjete transporti të përshtashme për rrethanat dhe sipas kushteve të zakonshme për një transportim të tillë.

3. Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të kryejë sigurimin në lidhje me transportimin e mallrave, ai, me kërkesë të blerësit, duhet t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm që i mundëson kryerjen e sigurimit.

Neni 33

Shitësi duhet të dorëzojë mallrat:

a) në qoftë se data është përcaktuar ose është e përcaktueshme nga kontrata, në atë datë;

b) në qoftë se një periudhë kohe është përcaktuar ose është e përcaktueshme nga kontrata,

në çdo kohë brenda kësaj periudhe, përveç kur rrethanat tregojnë që blerësi duhet të zgjedhë një datë; ose

c) në çdo rast tjetër, brenda një kohe të arsyeshme mbas lidhjes së kontratës.

Neni 34

Në qoftë se shitësi është i detyruar të dorëzojë dokumentet që kanë të bëjnë me mallrat, ai duhet t'i dorëzojë ato në vendin dhe kohën dhe në formën e kërkuar nga kontrata. Në qoftë se shitësi i ka dorëzuar dokumentet para kësaj kohe, ai, deri në atë kohë, mund të rregullojë çdo mospërputhje në dokumente, në rast se ushtrimi i kësaj të drejtë nuk i shkakton blerësit shqetësime apo shpenzime të paarsyeshme. Megjithatë, blerësi ruan çdo të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim siç parashikohet në këtë Konventë.

SEKSIONI II
PËRPUTHSHMËRIA E MALLRAVE DHE PRETENDIMET E PALËVE TË TRETA

Neni 35

1. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë në sasinë, cilësinë dhe përshkrimin e kërkuar në kontratë dhe të cilat mbyllen ose paketohen në mënyrën e kërkuar nga kontrata.

2. Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe, mallrat nuk janë në përputhje me kontratën përveç kur ato:

a) janë të përshtatshme për qëllimet për të cilat mallrat e të njëjtit përshkrim do të përdoreshin zakonisht;

b) janë të përshtatshme për çdo qëllim të veçantë, shprehimisht ose tërthorazi të bëra të ditura blerësit në kohën e lidhjes së kontratës, përveç kur rrethanat tregojnë që blerësi nuk u bazua ose ishte e paarsyeshme për atë të bazohej në aftësinë dhe gjykimin e shitësit;

c) zotërojnë cilësitë e mallrave që shitësi ia ka paraqitur blerësit si një mostër ose model;

d) mbyllen ose paketohen në mënyrën e zakonshme për këto mallra ose, kur nuk ka një mënyrë të tillë, në një mënyrë të përshtatshme për të ruajtur dhe mbrojtur mallrat.

3. Shitësi nuk është përgjegjes sipas nënparagrafëve (a) deri (d) të paragrafit të mësipërm për çdo mospërputhje të mallrave, në qoftë se në kohën e lidhjes së kontratës blerësi e dinte ose nuk mund të mos kishte dijeni për këtë mospërputhje.

Neni 36

1. Shitësi është përgjegjes në përputhje me kontratën dhe këtë Konventë për çdo mospërputhje e cila ekziston në kohën kur rreziku kalon te blerësi, megjithëse mospërputhja bëhet e qartë vetëm pas kësaj kohe.

2. Shitësi është gjithashtu përgjegjës për çdo mospërputhje e cila ndodh pas kohës së treguar në paragrafin e mësipërm dhe vjen si rezultat i shkeljes së një prej detyrimeve të tij, duke përfshirë shkeljen e çdo garancie që për një periudhë kohe mallrat të vazhdojnë të jenë të përshtashme për qëllimin e tyre të zakonshëm ose për ndonjë qëllim të veçantë, apo të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e specifikuara.

Neni 37

Në qoftë se shitësi i ka dorëzuar mallrat përpara datës së dorëzimit, ai mund, deri në atë ditë, të dorëzojë çdo pjesë që mungon ose të plotësojë ndonjë mungesë në sasinë e mallrave të dorëzuara ose të dorëzojë mallra për zëvendësimin e mallrave të dorëzuara që nuk përputhen ose rregullojë çdo mospërputhje në mallrat e dorëzuara, në rast se ushtrimi i kësaj të drejte nuk i

shkakton blerësit shqetësime apo shpenzime të paarsyeshme. Megjithatë, blerësi ruan çdo të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim siç parashikohet në këtë Konventë.

Neni 38

1. Blerësi duhet të ekzaminojë mallrat ose të bëjë që të ekzaminohen, brenda një periudhe po aq të shkurtër sa ç'është praktikë me rrethanat.

2. Në qoftë se kontrata përfshin transportimin e mallrave, ekzaminimi mund të shtyhet deri pas mbërritjes së mallrave në destinacionin e tyre.

3. Në qoftë se mallrat ndryshojnë drejtim në tranzit ose ridërgohen nga blerësi pa pasur mundësinë e arsyeshme për t'i ekzaminuar dhe në kohën e lidhjes së kontratës, shitësi e dinte ose duhej ta kishte ditur për mundësinë e ndryshimit të drejtimit ose ridërgimit, ekzaminimi mund të shtyhet deri pas mbërritjes së mallrave në destinacionin e ri.

Neni 39

1. Blerësi humb të drejtën për t'u bazuar në mospërputhjen e mallrave, në qoftë se nuk njofton shitësin duke specifikuar natyrën e mospërputhjes brenda një kohe të arsyeshme pasi e ka zbuluar atë ose duhet ta ketë zbuluar atë.

2. Në çdo rast, blerësi humb të drejtën për t'u bazuar në mospërputhjen e mallrave në qoftë se nuk njofton shitësin për këtë, të paktën brenda një periudhe 2-vjeçare nga data në të cilën mallrat iu dorëzuan në të vërtetë blerësit, përveç kur ky afat kohor nuk përputhet me periudhën e garancisë së kontraktuar.

Neni 40

Shitësi nuk ka të drejtë të bazohet në dispozitat e nenve 38 dhe 39, në qoftë se mospërputhja ka të bëjë me faktet për të cilat ai kishte dijeni ose nuk mund të mos i kishte dijeni dhe të cilat ai nuk ia bëri të njohura blerësit.

Neni 41

Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë të çliruara nga çdo e drejtë ose pretendim, përveç kur blerësi ka rënë dakord t'i marrë ato sipas kësaj të drejte apo pretendimi. Megjithatë, në qoftë se kjo e drejtë ose pretendim bazohet në pronësi industriale ose në pronësi tjetër intelektuale, detyrimi i shitësit rregullohet nga neni 42.

Neni 42

1. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë të çliruara nga çdo e drejtë ose pretendim të një pale të tretë, të bazuar në pronësinë industriale ose pronësi tjetër intelektuale, për të cilat në kohën e lidhjes së kontratës shitësi kishte dijeni ose nuk mund të mos kishte dijeni, nëse e drejta ose pretendimi bazohej në pronësinë industriale ose pronësi tjetër intelektuale:

a) sipas ligjit të shtetit ku do të rishiten ose në të kundërt përdoren mallrat, në qoftë se nga palët ishte parashikuar në kohën e lidhjes së kontratës së mallrat do të rishiteshin ose në të kundërt përdoreshin në këtë shtet, ose

b) në çdo rast tjetër, sipas ligjit të shtetit ku blerësi ka vendin e tij të biznesit.

2. Detyrimi i shitësit sipas paragrafit të mësipërm nuk përfshin rastin kur:

a) në kohën e lidhjes së kontratës blerësi kishte dijeni ose nuk mund të mos kishte dijeni për të drejtën ose pretendimin;ose

b) e drejta ose pretendimi rezulton nga përputhshmëria e shitësit me skicat, vizatimet, formulat teknike ose specifikime të tjera të tilla, të dhëna nga blerësi.

Neni 43

1. Blerësi humb të drejtën për t'u bazuar në dispozitat e neneve 41 dhe 42, në qoftë se ai nuk njofton shitësin duke specifikuar natyrën e së drejtës apo pretendimit të palës së tretë brenda një kohe të arsyshme, pasi është bërë me dijeni ose duhet të jetë bërë me dijeni për të drejtën dhe pretendimin.

2. Shitësi nuk ka drejtë të bazohet në dispozitat e paragrafit të mësipërm, në qoftë se ai kishte dijeni për të drejtën ose pretendimin e palës së tretë dhe natyrën e saj.

Neni 44

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit (1) të nenit 39 dhe paragrafit (1) të nenit 43, blerësi mund ta ulë çmimin në përputhje me nenin 50 ose kërkojë dëmshpërblim, me përjashtim të fitimit të munguar, në qoftë se ai ka një shfajësim të arsyeshëm për mosdhënien e njoftimit të kërkuar.

SEKSIONI III
DËMSHPËRBLIMI PËR SHKELJEN E KONTRATËS NGA SHITËSI

Neni 45

1. Në qoftë se shitësi nuk kryen ndonjë nga detyrimet e tij sipas kontratës ose kësaj Konvente, blerësi mund:

a) të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenet 46 deri 52;

b) kërkojë zhdëmtimin siç parashikohet në nenet 74 deri 77.

2. Blerësi nuk privohet nga e drejta që ai mund të ketë për të kërkuar zhdëmtim nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së tij për dëmshpërblimeve të tjera.

3. Asnjë periudhë falje nuk mund t'i jepet shitësit nga gjykata apo gjykata e arbitrazhit kur blerësi kërkon dëmshpërblim për shkeljen e kontratës.

Neni 46

1. Blerësi mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga shitësi, përveç kur blerësi kërkon një dëmshpërblim i cili është i papajtueshëm me këtë kërkesë.

2. Në qoftë se mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, blerësi mund të kërkojë dorëzimin e mallrave zëvendësuese vetëm në qoftë se mospërputhja përbën një shkelje thelbësore të kontratës dhe një kërkesë për mallra zëvendësuese bëhet ose së bashku me njoftimin e dhënë sipas nenit 39 ose brenda një kohe të pranueshme pas kësaj.

3. Në qoftë se mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, blerësi mund t'i kërkojë shitësit të rregullojë mospërputhjet, përveç kur kjo është e paarsyeshme duke pasur parasysh të gjitha rrethanat. Një kërkesë për riparim duhet të bëhet ose së bashku me njoftimin e dhënë sipas nenit 39 ose brenda një kohe të pranueshme pas kësaj.

Neni 47

1. Blerësi mund të përcaktojë një periudhë kohe shtesë me kohëzgjatje të arsyeshme për përmbushjen e detyrimeve nga shitësi.

2. Përveç kur blerësi ka marrë njoftim nga shitësi se ai nuk do të përmbushë detyrimin brenda kohës së përcaktuar, blerësi nuk mund t'i kërkojë, gjatë kësaj kohe, asnjë dëmshpërblim për shkeljen e kontratës. Megjithatë, blerësi nuk privohet në këtë mënyrë nga e drejta që ai mund

të ketë për të kërkuar zhdëmtim për përmbushjen me vonesë të detyrimit.

Neni 48

1. Sipas nenit 49, shitësi, edhe mbas datës së dorëzimit, mund të rregullojë me shpenzimet e tij çdo mospërmbushje të detyrimit, në qoftë se ai mundet pa vonesë të paarsyeshme dhe pa i shkaktuar blerësit shqetësime të paarsyeshme ose pasiguri të rimbursimit të shpenzimeve të parapaguara nga blerësi. Megjithatë, blerësi ruan çdo të drejtë për të kërkuar zhdëmtim siç parashikohet në këtë Konventë.

2. Në qoftë se shitësi i kërkon blerësit t'i bëjë të ditur nëse ai do të pranojë përmbushjen e detyrimit dhe blerësi nuk i përgjigjet kërkesës brenda një kohe të arsyeshme, shitësi mund ta përmbushë atë brenda kohës së treguar në kërkesën e tij. Blerësi, gjatë kësaj kohe, nuk mund të kërkojë asnjë dëmshpërblim për shkeljen e kontratës.

3. Një njoftim nga shitësi se ai do ta përmbushë detyrimin brenda periudhës së specifikuar të kohës prezumohet të përfshijë një kërkesë, sipas paragrafit të mësipërm, që blerësi të bëjë të ditur vendimin e tij.

4. Një kërkesë ose njoftim nga shitësi sipas paragrafit (2) ose (3) të këtij neni nuk është efektiv, përveç kur merret nga blerësi.

Neni 49

1. Blerësi mund të deklarojë kontratën të pavlefshme:

a) në qoftë se mospërmbushja nga shitësi e çdo detyrimi të tij sipas kontratës dhe kësaj Konvente përbën një shkelje thelbësore të kontratës; ose

b) në rast të mosdorëzimit, në qoftë se shitësi nuk i dorëzon mallrat brenda periudhës së kohës shtesë, të përcaktuar nga blerësi në përputhje me paragrafin (1) të nenit 47 ose deklaron se ai nuk do t'i dorëzojë ato brenda kësaj periudhe.

2. Megjithatë, në rastet kur shitësi i ka dorëzuar mallrat, blerësi e humb të drejtën që ta deklarojë kontratën të pavlefshme, përveç kur ai vepron në këtë mënyrë:

a) në lidhje me dorëzimin me vonesë, brenda një kohe të arsyeshme pasi ai ka marrë dijeni se dorëzimi është bërë;

b) në lidhje me çdo shkelje të kontratës, përveç dorëzimit me vonesë, brenda një kohe të arsyeshme;

i) pasi ai kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni për shkeljen;

ii) pas skadimit të çdo periudhe kohe shtesë të përcaktuar nga blerësi në përputhje me paragrafin (1) të nenit 47, ose pasi shitësi ka deklaruar se ai nuk do ta përmbushë detyrimin e tij brenda periudhës së kohës shtesë; ose

iii) pas skadimit të çdo periudhe kohe shtesë të treguar nga shitësi në përputhje me paragrafin (2) të nenit 48, ose pasi blerësi ka deklaruar se ai nuk do ta pranojë përmbushjen e detyrimit.

Neni 50

Në qoftë se mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, qoftë kur çmimi është paguar ose jo, blerësi mund ta ulë çmimin në të njëjtën raport që ka vlera që mallrat e dorëzuara aktualisht kishin në kohën e dorëzimit, me vlerën që mallrat në përputhje do të kishin pasur në atë kohë. Megjithatë, në qoftë se shitësi dëmshpërblen çdo mospërmbushje të detyrimit të tij në pajtim me nenin 37 ose nenin 48 ose në qoftë se blerësi refuzon të pranojë përmbushjen e detyrimit nga shitësi në përputhje me ato nene, blerësi nuk mund ta ulë çmimin.

Neni 51

1. Në qoftë se shitësi dorëzon vetëm një pjesë të mallrave ose në qoftë se një pjesë e mallrave të dorëzuara është në përputhje me kontratën, nenet 46 deri në 50 zbatohen në lidhje me pjesën e cila mungon ose nuk është në përputhje me kontratën.

2. Blerësi mund ta deklarojë kontratën të pavlefshme në tërësinë e saj vetëm në qoftë se mosdorëzimi i plotë i mallrave ose mospërputhja e tyre me kontratën përbën një shkelje thelbësore të kontratës.

Neni 52

1. Në qoftë se shitësi dorëzon mallrat para datës së përcaktuar, blerësi mund t'i marrë në dorëzim ose të refuzojë t'i marrë në dorëzim.

2. Në qoftë se shitësi dorëzon një sasi më të madhe se ajo e parashikuar në kontratë, blerësi mund t'i marrë ato në dorëzim ose të refuzojë të marrë në dorëzim sasinë e tepërt. Në qoftë se blerësi merr në dorëzim të gjithë ose një pjesë të sasisë së tepërt, ai duhet të paguajë për të në çmimin e kontratës.

KAPITULLI III
DETYRIMET E BLERËSIT

Neni 53

Blerësi duhet të paguajë çmimin e mallrave dhe t'i marrë ato në dorëzim siç kërkohet nga kontrata dhe kjo Konventë.

SEKSIONI I
PAGIMI I ÇMIMIT

Neni 54

Detyrimi i blerësit për të paguar çmimin përfshin marrjen e atyre masave dhe plotësimin e atyre formaliteteve siç kërkohet nga kontrata ose çdo ligj dhe rregullore që mundëson kryerjen e pagesës.

Neni 55

Kur një kontratë është lidhur në mënyrë të vlefshme, por nuk përcakton ose parashikon shprehimisht ose tërthorazi vendosjen e çmimit, palët konsiderohen, në mungesë të çdo treguesi të kundërt, t'i jenë referuar në mënyrë indirekte çmimit të paguar në përgjithësi në kohën e lidhjes së kontratës për këto mallra të shitura sipas rrethanave të krahasueshme në tregtinë përkatëse.

Neni 56

Në qoftë se çmimi përcaktohet sipas peshës së mallrave, në rast dyshimi duhet të përcaktohet nga pesha neto.

Neni 57

1. Në qoftë se blerësi nuk detyrohet të paguajë çmimin në ndonjë vend tjetër të veçantë, ai duhet t'ia paguajë atë shitësit:

a) në vendin e biznesit të shitësit; ose

b) në qoftë se pagesa duhet të bëhet kundrejt dorëzimit të mallrave ose dokumenteve, në vendin ku ndodh dorëzimi.

2. Shitësi duhet të përballojë çdo rritje të shpenzimeve shtesë ndaj pagesës e cila është shkaktuar nga një ndryshim i vendit të tij të biznesit mbas lidhjes së kontratës.

Neni 58

1) Në qoftë se blerësi nuk detyrohet të paguajë çmimin në ndonjë kohë tjetër të veçantë, ai duhet ta paguajë atë aty ku shitësi vendos qoftë mallrat ose dokumentet që verifikojnë natyrën e tyre, në dispozicion të blerësit në përputhje me kontratën dhe këtë Konventë. Shitësi mund ta caktojë këtë pagim si kusht për dorëzimin e mallrave ose dokumenteve.

2) Në qoftë se kontrata përfshin transportin e mallrave, shitësi mund t'i dërgojë ato në kushte në të cilat mallrat, ose dokumentet që verifikojnë natyrën e tyre, nuk do t'i dorëzohen blerësit përveç kundrejt pagimit të çmimit.

3) Blerësi nuk detyrohet të paguajë çmimin deri sa ai të ketë mundësinë të ekzaminojë mallrat, përveç kur procedurat e rëna dakord për dorëzim ose pagim nga palët janë kontradiktore me këtë mundësi.

Neni 59

Blerësi mund të paguajë çmimin në datën e përcaktuar ose të përcaktueshme nga kontrata dhe kjo Konventë pa pasur nevojë për ndonjë kërkesë ose plotësim të ndonjë formaliteti nga ana e shitësit.

SEKSIONI II
MARRJA NË DORËZIM

Neni 60

Detyrimi i blerësit për marrjen në dorëzim konsiston:

a) në kryerjen e të gjitha veprimeve të cilat mund të priten në mënyrë të arsyeshme prej tij me qëllim që të mundësojnë shitësin të bëjë dorëzimin; dhe

b) në marrjen në dorëzim të mallrave.

SEKSIONI III
DËMSHPËRBLIME PËR SHKELJEN E KONTRATËS NGA BLERËSI

Neni 61

1. Në qoftë se blerësi nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kontratës ose kësaj Konvente, shitësi mund:

a) të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenet 62 deri 65;

b) të kërkojë zhdëmtim siç parashikohet në nenet 74 deri 77.

2. Shitësi nuk privohet nga asnjë e drejtë që mund të ketë për të kërkuar zhdëmtim nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së tij për dëmshpërblime të tjera.

3. Asnjë periudhë falje nuk mund t'i jepet blerësit nga gjykata ose gjykata e arbitrazhit kur shitësi kërkon dëmshpërblim për shkeljen e kontratës.

Neni 62

Shitësi mund t'i kërkojë blerësit të paguajë çmimin, të marrë në dorëzim ose të përmbushë detyrimet e tjera, përveç kur shitësi ka kërkuar një dëmshpërblim, i cili është kontradiktor me këtë kërkesë.

Neni 63

1. Shitësi mund të caktojë një periudhë kohe shtesë me kohëzgjatje të arsyeshme për përmbushjen nga blerësi të detyrimit të tij

2. Përveç kur shitësi ka marrë njoftim nga blerësi se ai nuk do ta përmbushë detyrimin brenda periudhës së caktuar, shitësi, gjatë kësaj periudhe, nuk mund t'i kërkojë ndonjë dëmshpërblim për shkelje të kontratës. Megjithatë, shitësi nuk privohet nga ndonjë e drejtë që mund të ketë për të kërkuar zhdëmtim për vonesë në përmbushje të detyrimit.

Neni 64

1. Shitësi mund ta deklarojë kontratën të pavlefshme:

a) në qoftë se mospërmbushja nga blerësi e çdo detyrimi të tij sipas kontratës ose kësaj Konvente përbën një shkelje thelbësore të kontratës, ose

b) në qoftë se blerësi nuk përmbush, brenda periudhës së kohës shtesë të caktuar nga shitësi në përputhje me paragrafin (1) të nenit 63, detyrimin e tij për të paguar çmimin ose për të marrë në dorëzim mallrat, ose në qoftë se ai deklaron se nuk do ta kryejë atë brenda kohës së caktuar;

2. Megjithatë, në rastet kur blerësi ka paguar çmimin, shitësi e humb të drejtën ta deklarojë kontratën të pavlefshme, përveç kur ai vepron kështu:

a) në lidhje me përmbushjen me vonesë të detyrimit nga blerësi, para se shitësi të ketë marrë dijeni se përmbushja është kryer;

b) në lidhje me çdo shkelje tjetër të kontratës përveç përmbushjes së detyrimit, brenda një kohe të arsyeshme:

i) pasi shitësi kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni për shkeljen; ose

ii) pas skadimit të çdo periudhe kohe shtesë, të përcaktuar nga shitësi në përputhje me paragrafin (1) të nenit 63, ose pasi blerësi ka deklaruar se ai nuk do ta përmbushë detyrimin e tij brenda periudhës shtesë.

Neni 65

1. Në qoftë se sipas kontratës blerësi duhet të specifikojë formën, matjen ose tipare të tjera të mallrave dhe ai nuk i kryen këto specifikime qoftë në datën e rënë dakord ose brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së kërkesës nga shitësi, shitësi, pa cenuar ndonjë të drejtë që ai mund të ketë, mund të kryejë vetë specifikimet në përputhje me kërkesat e blerësit që mund t'i jenë bërë të njohura atij.

2. Në qoftë se shitësi i bën vetë specifikimet, ai duhet të informojë blerësin për hollësitë e tyre dhe duhet të caktojë një kohë të arsyeshme brenda së cilës blerësi mund të bëjë një specifikim të ndryshëm. Në qoftë se, pas marrjes së këtij komunikimi, blerësi nuk e bën këtë brenda kohës së caktuar, specifikimi i bërë nga shitësi është detyrues.

KAPITULLI IV
KALIMI I RREZIKUT

Neni 66

Humbja ose dëmtimi i mallrave pas kalimit të rrezikut të blerësi nuk e çliron atë nga detyrimi i tij për të paguar çmimin, përveç kur humbja ose dëmtimi ndodh për shkak të një veprimi ose mosveprimi të shitësit.

Neni 67

1. Në qoftë se kontrata e shitjes përfshin transportin e mallrave dhe shitësi nuk detyrohet t'i dorëzojë ato në një vend të veçantë, rreziku kalon te blerësi kur mallrat dorëzohen te transportuesi i parë për ridërgimin e tyre te blerësi në përputhje me kontratën e shitjes. Në qoftë se shitësi detyrohet t'i dorëzojë mallrat te një transportues në një vend të veçantë, rreziku nuk kalon te blerësi derisa mallrat t'i dorëzohen transportuesit në atë vend. Fakti që shitësi autorizohet t'i mbajë dokumentet që kontrollojnë disponimin e tyre nuk ndikon tek kalimi i rrezikut.

2. Megjithatë, rreziku nuk i kalon blerësit derisa mallrat të jenë identifikuar qartë sipas kontratës, qoftë duke i vënë shenjë mallrave, dokumentet e dërgesës, duke njoftuar blerësin ose çdo mënyrë tjetër.

Neni 68

Rreziku në lidhje me mallrat e shitura në tranzit i kalon blerësit nga koha e lidhjes së kontratës. Megjithatë, nëse rrethanat tregojnë këtë, rreziku merret përsipër nga blerësi që nga koha kur mallrat dorëzohen te transportuesi i cili lëshoi dokumentet që përfaqësojnë kontratën e transportit. Megjithatë, në qoftë se në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes shitësi kishte dijeni ose duhet të kishte dijeni se mallrat kishin humbur ose ishin dëmtuar dhe nuk ia tregoi këtë blerësit, humbja ose dëmtimi janë në ngarkim të shitësit.

Neni 69

1. Në rastet e parashikuara në nenet 67 dhe 68, rreziku i kalon blerësit kur ai merr në dorëzim mallrat ose, në qoftë se nuk vepron kështu në kohën e duhur, nga koha kur mallrat vihen në dispozicion të tij dhe ai kryen shkelje të kontratës me mosmarrjen në dorëzim të tyre.

2. Megjithatë, në qoftë se blerësi detyrohet të marrë në dorëzim mallrat në një vend tjetër nga vendi i biznesit të shitësit, rreziku kalon kur dorëzimi kryhet dhe blerësi ka dijeni për faktin se mallrat janë vënë në dispozicionin e tij në atë vend.

3. Në qoftë se kontrata ka të bëjë me mallrat ende të paidentifikuara, mallrat konsiderohen si jo të vëna në dispozicion të blerësit deri sa ato të jenë identifikuar qartë sipas kontratës.

Neni 70

Në qoftë se shitësi ka kryer një shkelje thelbësore të kontratës, nenet 67, 68 dhe 69 nuk cenojnë dëmshpërblimet e vlefshme për blerësin për shkak të shkeljes.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA TË DETYRIMEVE TË SHITËSIT E BLERËSIT

SEKSIONI I
SHKELJE TË PARAKOHSHME DHE KONTRATA ME KËSTE

Neni 71

1. Një palë mund të pezullojë përmbushjen e detyrimit të tij në qoftë se, pas lidhjes së kontratës, bëhet e qartë se pala tjetër nuk do të përmbushë një pjesë thelbësore të detyrimit të tij si rezultat:

a) i një mangësie serioze në aftësinë e tij për ta përmbushur atë ose në besueshmërinë financiare, ose

b) i sjelljes së tij në përgatitjen për ta përmbushur atë ose gjatë zbatimit të kontratës.

2. Në qoftë se shitësi i ka dërguar mallrat para se arsyet e përshkruara në paragrafin e mësipërm të bëhen të qarta, ai mund t'ia parandalojë dorëzimin e mallrave blerësit edhe sikur blerësi të mbajë dokumentin që i jep të drejtë t'i marrë ato. Ky paragraf i referohet vetëm të drejtave për mallrat ndërmjet blerësit dhe shitësit.

3. Një palë që pezullon përmbushjen e detyrimit, qoftë para ose pas dërgimit të mallrave, duhet t'i njoftojë menjëherë palës tjetër pezullimin dhe duhet të vazhdojë me përmbushjen, në qoftë se pala tjetër jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimit të vet.

Neni 72

1. Në qoftë se para datës së përmbushjes së kontratës është e qartë se njëra nga palët do të kryejë një shkelje thelbësore të kontratës, pala tjetër mund ta deklarojë kontratën të anuluar.

2. Nëse koha e lejon, pala që synon ta deklarojë të anuluar kontratën duhet t'i japë palës tjetër njoftim të arsyeshëm, me qëllim që t'i lejojë atij të japë siguri të mjaftueshme për përmbushjen e tij.

3. Kërkesat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen në qoftë se pala tjetër ka deklaruar se ajo nuk do të përmbushë detyrimin e saj.

Neni 73

1. Në rastin e një kontrate për dorëzimin në pjesë të mallrave, nëse mospërmbushja e çdo detyrimi të njërës palë në lidhje me secilën pjesë përbën një shkelje thelbësore të kontratës për këtë pjesë, pala tjetër mund ta deklarojë të anuluar kontratën në lidhje me këtë pjesë.

2. Në qoftë se mospërmbushja e detyrimit të njërës palë në lidhje me secilën pjesë i jep shkak palës tjetër të arrijë në konluzionin se një shkelje thelbësore e kontratës do të ndodhë në lidhje me pjesët e ardhshme, ajo mund ta deklarojë kontratën të anuluar për të ardhmen, me kusht që ai ta bëjë këtë brenda një kohe të arsyeshme.

3. Blerësi i cili e deklaron kontratën të anuluar në lidhje me çdo dorëzim, në të njëjtën kohë, e deklaron atë të anuluar në lidhje me dorëzimet e bëra ose dorëzimet e ardhshme në qoftë se, për shkak të ndërvarësisë së tyre, ato dorëzime nuk mund të përdoreshin për qëllimin e parashikuar nga palët në kohën e lidhjes së kontratës.

SEKSIONI II
DËMET

Neni 74

Dëmet për shkeljen e kontratës nga njëra palë konsistojnë në një shumë të barabartë me humbjen, duke përfshirë fitimin e munguar, të pësuar nga pala tjetër si pasojë e shkeljes. Dëme të tilla nuk duhet të tejkalojnë humbjen, të cilën pala shkelëse parashikoi ose duhej të parashikonte në kohën e lidhjes së kontratës, duke marrë parasysh faktet dhe çështjet për të cilat ai kishte dijeni që atëherë ose duhej të kishte dijeni, si një pasojë e mundshme e shkeljes së kontratës.

Neni 75

Në qoftë se kontrata anulohet dhe në qoftë se, në një mënyrë të arsyeshme dhe brenda një kohe të arsyeshme pas anulimit, blerësi ka blerë mallra për zëvendësim ose shitësi i ka rishitur ato, pala që kërkon zhdëmtimin mund të rekuperojë diferencën ndërmjet çmimit të kontratës dhe çmimit të transaksionit zëvendësues, si dhe çdo zhdëmtim tjetër që mund të merret sipas nenit 74.

Neni 76

1. Në qoftë se kontrata anulohet dhe ka një çmim aktual për mallrat, pala që kërkon zhdëmtim mund, në qoftë se nuk ka bërë një blerje ose rishitje sipas nenit 75, të rekuperojë diferencën ndërmjet çmimit të caktuar në kontratë dhe çmimit aktual në kohën e anulimit, si dhe çdo zhdëmtim të mëtejshëm të marrë sipas nenit 74. Megjithatë, në qoftë se, pala që kërkon zhdëmtim ka anuluar kontratën pas marrjes së mallrave, çmimi aktual në kohën e marrjes së tyre në dorëzim do të aplikohet në vend të çmimit aktual në kohën e anulimit.

2. Për qëllime të paragrafit të mësipërm, çmimi aktual është çmimi mbizotërues në vendin ku duhej të bëhej dorëzimi i mallrave ose, në qoftë se nuk ka një çmim të tillë në atë vend, çmimi në një vend tjetër që shërben si një alternativë e arsyeshme, duke kryer pagesën e duhur për diferencat në koston e transportimit të mallrave.

Neni 77

Pala që bazohet në shkeljen e kontratës duhet të marrë masa të tilla që të jenë të arsyeshme me rrethanat për të zvogëluar humbjen, duke përfshirë fitimin e munguar, që rezulton nga shkelja e kontratës. Në qoftë se ajo nuk i merr këto masa, pala në shkelje mund të kërkojë një ulje të zhdëmtimit në shumën me të cilën humbja duhet të ishte zvogëluar.

SEKSIONI III
INTERESI

Neni 78

Në qoftë se pala nuk paguan çmimin ose ndonjë shumë tjetër të prapambetur, pala tjetër ka të drejtën e interesit mbi të, pa cenuar ndonjë kërkesë për zhdëmtim që mund të marrë sipas nenit 74.

SEKSIONI IV
PËRJASHTIMI

Neni 79

1. Njëra palë nuk është përgjegjëse për mospërmbushjen e çdonjë prej detyrimeve të saj, në qoftë se provon se mospërmbushja i detyrohej një pengese jashtë kontrollit të saj dhe se nuk mund të pritej në mënyrë të arsyeshme që të merrte parasysh pengesën në kohën e lidhjes së kontratës ose të shmangte ose kapërcente atë apo pasojat e saj.

2. Në qoftë se mospërmbushja e palës i detyrohet mospërmbushjes së një personi të tretë të cilin ajo e ka angazhuar për të përmbushur tërësisht ose pjesërisht kontratën, ajo palë përjashtohet nga përgjegjësia vetëm në qoftë se:

a) ajo përjashtohet sipas paragrafit të mësipërm; dhe

b) personi i angazhuar prej saj do të përjashtohej në qoftë se dispozitat e këtij paragrafi do të zbatoheshin ndaj tij.

3. Përjashtimi i parashikuar në këtë nen ka efekt për periudhën gjatë së cilës ekzistonte pengesa.

4. Pala e cila nuk përmbush detyrimin, duhet të njoftojë palën tjetër për pengesën dhe

efektet e saj mbi aftësinë e saj për ta përmbushur. Në qoftë se njoftimi nuk merret nga pala tjetër brenda një kohe të arsyeshme, pasi pala e cila nuk përmbush detyrimin kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni për pengesën, ajo është përgjegjëse për dëmet që rezultojnë nga mosmarrja e njoftimit.

5. Asgjë në këtë nen nuk pengon asnjërën palë nga ushtrimi i çdo të drejte krahas asaj të kërkimit të zhdëmtimit sipas kësaj Konvente.

Neni 80

Një palë nuk mund të bazohet në mospërmbushjen e palës tjetër, për sa kjo mospërmbushje shkaktohet nga veprimi ose mosveprimi i palës së parë.

SEKSIONI V
EFEKTET E ANULIMIT

Neni 81

1. Anulimi i kontratës liron të dyja palët nga detyrimet e tyre në përputhje me të, në vartësi të çdo dëmi që mund të jetë i detyrueshëm. Anulimi nuk ndikon asnjë dispozitë të kontratës për zgjidhen e mosmarrëveshjeve ose ndonjë dispozitë tjetër të kontratës që rregullon të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga anulimi i kontratës.

2. Një palë e cila ka përmbushur kontratën tërësisht ose pjesërisht, mund të kërkojë nga pala tjetër kthimin e çdogjëje që pala e parë i ka dhënë ose paguar sipas kontratës. Në qoftë se të dyja palët janë të detyruara ta bëjnë kthimin, ato duhet ta bëjnë atë në të njëtjën kohë.

Neni 82

1. Blerësi humb të drejtën ta deklarojë kontratën të anuluar ose t'i kërkojë shitësit të dorëzojë mallrat zëvendësuese në qoftë se është e pamundur për atë të bëjë kthimin e mallrave kryesisht në kushtet në të cilat ai i mori ato.

2. Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet:

a) në qoftë se pamundësia e kthimit të mallrave ose kthimit të mallrave kryesisht në kushte në të cilat blerësi i mori ato, nuk i detyrohet veprimit ose mosveprimit të tij;

b) në qoftë se mallrat ose pjesë të mallrave kanë humbur ose janë dëmtuar si rezultat i ekzaminimit të parashikuar në nenin 38; ose

c) në qoftë se mallrat ose pjesë e tyre janë shitur gjatë rrjedhës normale të biznesit ose janë konsumuar ose transformuar nga blerësi gjatë përdorimit normal para se ai të zbulonte ose duhej të kishte zbuluar mungesën e përputhshmërisë.

Neni 83

Blerësi i cili ka humbur të drejtën ta deklarojë të anuluar kontratën ose t'i kërkojë shitësit të dorëzojë mallrat zëvendësuese në përputhje me nenin 82, ruan të drejtën e të gjitha dëmshpërblimeve sipas kontratës dhe kësaj Konvente.

Neni 84

1. Në qoftë se shitësi detyrohet të ripaguajë çmimin, ai gjithashtu duhet të paguajë interesat mbi të nga data në të cilën u pagua çmimi.

2. Blerësi duhet t'i japë llogari shitësit për të gjitha përfitimet të cilat kanë rrjedhur nga

mallrat ose pjesë të tyre:

a) në qoftë se ai duhet të kthejë mallrat ose pjesë të tyre; ose

b) në qoftë se nuk është e mundur për të kthimi i të gjitha ose të një pjese të mallrave ose kthimi i të gjitha ose të një pjesë të mallrave kryesisht në kushte në të cilat ai i mori, por ai megjithatë e ka deklaruar të anuluar kontratën ose i ka kërkuar shitësit të dorëzojë mallrat zëvendësuese.

SEKSIONI VI
RUAJTJA E MALLRAVE

Neni 85

Në qoftë se blerësi është me vonesë në marrjen e mallrave në dorëzim ose, kur pagimi i çmimit dhe dorëzimi i mallrave duhet të bëhet në të njëjtën kohë, në qoftë se ai nuk paguan çmimin, dhe shitësi është si në zotërim të mallrave dhe në gjendje të kontrollojë disponimin e tyre, shitësi duhet të marrë ato masa që janë të arsyeshme me rrethanat për t'i ruajtur ato. Ai ka të drejtën t'i ruajë ato derisa të gjitha shpenzimet t'i jenë rimbursuar nga blerësi.

Neni 86

1. Në qoftë se blerësi i ka marrë mallrat dhe synon të ushtrojë çdo të drejtë sipas kontratës dhe kësaj Konvente për t'i refuzuar ato, ai duhet të marrë të gjitha masat për t'i ruajtur ato aq sa të jenë të arsyeshme me rrethanat. Ai ka të drejtën t'i ruajë ato derisa ai të ketë rimbursuar shpenzimet e tij të arsyeshme nga shitësi.

2. Në qoftë se mallrat e dërguara blerësit janë vënë në dispozicion të tij në destinacionin e tyre dhe ai ushtron të drejtën për t'i refuzuar ato, ai duhet të marrë zotërimin e tyre në emër të shitësit, me kushte që kjo të mund të bëhet pa paguar çmimin dhe shqetësime të paarsyeshme ose shprenzime të paarsyeshme.

Kjo dispozitë nuk zbatohet në qoftë se shitësi ose një person i autorizuar për të marrë në ngarkim mallrat në emër të tij është i pranishëm në destinacion. Në qoftë se blerësi merr në zotërim mallrat sipas këtij paragrafi, të drejtat dhe detyrimet e tij rregullohen nga paragrafi i mësipërm.

Neni 87

Pala e cila detyrohet të marrë masa për ruajtjen e mallrave, mund t'i depozitojë ato në një magazinë, të një personi të tretë, me shpenzimet e palës tjetër, me kusht që këto shpenzime të hasura të mos jenë të paarsyeshme.

Neni 88

1. Pala e cila detyrohet të ruajë mallrat në përputhje me nenin 85 ose 86, mund t'i shesë ato me çdo mjet të përshtatshëm, në qoftë se ka pasur një vonesë të paarsyeshme nga pala tjetër në marrjen në zotërim të mallrave ose në kthimin e tyre ose në pagimin e çmimit apo kostos së ruajtjes, me kusht që palës tjetër t'i jetë dhënë një njoftim i arsyeshëm i qëllimit për shitjen e tyre.

2. Në qoftë se mallrat janë subjekt i dëmtimit të shpejtë ose ruajtja e tyre do të përfshinte shpenzime të paarsyeshme, pala e cila detyrohet të ruajë mallrat në përputhje me nenin 85 dhe 86 duhet të marrë masa të arsyeshme për t'i shitur ato. Kur të jetë e mundshme ajo duhet të njoftojë palën tjetër për qëllimin e saj për t'i shitur ato.

3. Pala që shet mallrat ka të drejtën të mbajë nga të ardhurat e shitjes një shumë të barabartë me shpenzimet e arsyeshme për ruajtjen e mallrave dhe shitjen e tyre. Ai duhet t'i japë

llogari palës tjetër për bilancin.

PJESA IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 89

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara këtu caktohet si i autorizuari i kësaj Konvente.

Neni 90

Kjo Konventë nuk mbizotëron mbi ndonjë marrëveshje ndërkombëtare e cila ka qenë ose mund të jetë lidhur dhe përmban dizpozita që kanë të bëjnë me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, me kusht që palët të kenë vendin e tyre të biznesit në shtetet palë, për këtë marrëveshje.

Neni 91

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në përfundim të takimit të konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave dhe do të qëndrojë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet në selinë e Kombeve të Bashkuara, New York deri më 30 shtator 1981.

2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtete nënshkruese.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet të cilat nuk janë shtete nënshkruese që nga data e hapjes për nënshkrim.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit i depozitohen Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 92

1. Një shtet kontraktues mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit se nuk do të jetë i detyruar nga pjesa II e kësaj Konvente ose pjesa III e kësaj Konvente.

2. Një shtet kontraktues i cili bën një deklarim në përputhje me paragrafin e mësipërm në lidhje me pjesën e II ose pjesën e III të kësaj Konvente nuk do të konsiderohet si shtet Kontraktues sipas paragrafit (1) të nenit (1) të kësaj Konvente, në lidhje me çështjet e rregulluara nga pjesa për të cilën zbatohet deklarimi.

Neni 93

1. Në qoftë se një shtet kontraktues ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat në përputhje me kushtetutën e saj, zbatohen sisteme ligjore të ndryshme në lidhje me çështjet që trajton kjo Konventë, ai, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë e saj territoriale ose vetëm tek një ose më shumë prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklarimin e tij duke paraqitur një deklarim tjetër në çdo kohë.

2. Këto deklarime duhet t'i njoftohen të autorizuarit dhe duhet të tregojnë shprehimisht

njësitë territoriale në të cilat shtrihet Konventa.

3. Në qoftë se, për shkak të deklarimit sipas këtij neni, kjo Konventë shtrihet tek një ose më shumë prej tyre, por jo në të gjitha njësitë territoriale të shtetit kontraktues, dhe në qoftë se vendi i biznesit i një pale ndodhet në atë shtet, ky vend biznesi për qëllimet e kësaj Konvente, konsderohet se nuk është në një shtet kontraktues, përveç kur është një njësi territoriale në të cilën shtrihet Konventa.

4. Në qoftë se një Shtet Kontraktues nuk bën deklarime sipas paragrafit (1) të këtij neni, Konventa shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.

Neni 94

1. Dy ose më shumë shtete kontraktuese të cilat kanë rregulla ligjore të njëjta ose të përafërta për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, në çdo kohë mund të deklarojnë se Konventa nuk zbatohet për kontratat e shitjes ose formimin e tyre kur palët kanë vendin e tyre të biznesit në ato shtete. Këto deklarime mund të bëhen bashkërisht ose me deklarime reciproke të njëanshme.

2. Një shtet kontraktues i cili ka rregulla ligjore të njëjta ose të përafërta për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, ashtu si një apo shumë shtete jokontraktuese, mund të deklarojë në çdo kohë se Konventa nuk zbatohet për kontratat e shitjes ose formimin e tyre kur palët kanë vendin e tyre të biznesit në ato shtete.

3. Në qoftë se një shtet, i cili është objekti i një deklarimi sipas paragrafit të mësipërm, bëhet më pas shtet kontraktues, deklarimi i bërë do të ketë efektin e një deklarimi të bërë sipas paragrafit (1), që nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi në lidhje me shtetin e ri kontraktues, me kusht që shteti i ri kontraktues t'i bashkohet këtij deklarimi ose bën një deklarim reciprok të njëanshëm.

Neni 95

Çdo shtet mund të deklarojë në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit se nuk do të jetë i detyruar sipas nënparagrafit (1) (b) të nenit 1 të kësaj Konvente.

Neni 96

Një shtet kontraktues, legjislacioni i të cilit kërkon që kontratat e shitjes të lidhen ose të evidentohen me shkrim, mund të bëjë në çdo kohë një deklarim në përputhje me nenin 12, se çdo dispozitë e nenit 11, nenit 29 ose pjesës së II të kësaj Konvente, që lejon një kontratë shitje ose ndryshimin ose përfundimin e saj me marrëveshje apo çdo ofertë, pranim ose tregues tjetër të qëllimit të bërë në çdo formë tjetër krahas asaj me shkrim, nuk zbatohet kur çdo palë ka vendin e biznesit në atë shtet.

Neni 97

1. Deklarimet e bëra sipas kësaj Konvente në kohën e nënshkrimit janë subjekt i konfirmimit me ratifikim, pranim ose miratim.

2. Deklarimet dhe konfirmimet e deklarimeve duhet jenë me shkrim dhe t'i njoftohen formalisht të autorizuarit.

3. Një deklarim merr efekt njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me

shtetin përkatës. Megjithatë, një deklarim për të cilin i autorizuari merr njoftim formal pas hyrjes në fuqi, merr efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të gjashtë muajve, pas datës së marrjes së saj nga i autorizuari. Deklarimet reciproke të njëanshme sipas nenit 94 marrin efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të gjashtë muajve, pas marrjes së deklarimit të fundit nga i autorizuari.

4. Çdo shtet i cili bën një deklarim sipas kësaj Konvente, mund ta tërheqë atë në çdo kohë përmes një njoftimi formal me shkrim, adresuar të autorizuarit. Kjo tërheqje merr efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të gjashtë muajve, pas datës së marrjes së njoftimit nga i autorizuari.

5. Tërheqja e deklarimit e bërë sipas nenit 94 bën të paefektshëm, që nga data në të cilën tërheqja merr efekt, çdo deklarim reciprok të bërë nga një shtet tjetër sipas atij neni.

Neni 98

Asnjë kusht nuk lejohet, përveç atyre të autorizuara shprehimisht në këtë Konventë.

Neni 99

1. Kjo Konventë hyn në fuqi, sipas dispozitave të paragrafit 6 të këtij neni, në ditën e parë të muajit pas përfundimit të dymbëdhjetë muajve, pas datës së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, duke përfshirë një instrument i cili përmban një deklarim të bërë sipas nenit 92.

2. Kur një Shtet ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, kjo Konventë, me përjashtim të pjesës së përjashtuar, hyn në fuqi në lidhje me këtë shtet, sipas dispozitave të paragrafit (6) të këtij neni, në ditën e parë të muajit pas përfundimit të dymbëdhjetë muajve, pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Një shtet i cili ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë dhe është palë te ndonjëra ose te të dyja, Konventa në lidhje me Ligjin Uniform mbi Formimin e Kontratave për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave bërë në Hagë më 1 korrik 1964 (Konventa e Formimit në Hagë të vitit 1964) dhe Konventa në lidhje me Ligjin Uniform mbi Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave bërë në Hagë më 1 korrik 1964 (Konventa e Shitjeve në Hagë e vitit 1964) do të denoncojë në të njëtjën kohë, sipas rastit, çdonjërën ose të dyja, Konventën e Shitjeve në Hagë e 1964-ës dhe Konventën e Formimit në Hagë të 1964-ës duke njoftuar qeverinë e Hollandës për këtë efekt.

4. Një Shtet palë në Konventën e Shitjeve në Hagë të 1964-ës, e cila ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë dhe deklaron ose ka deklaruar sipas nenit 92 se nuk do të jetë e detyruar nga pjesa II e kësaj Konvente, do ta denoncojë në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit Konventën e Shitjeve në Hagë të 1964-ës duke njoftuar qeverinë e Hollandës për këtë efekt.

5. Një shtet palë në Konventën e Formimit në Hagë të 1964-ës, e cila ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë dhe deklaron ose ka deklaruar sipas nenit 92 se nuk do të jetë e detyruar nga pjesa III e kësaj Konvente, do të denoncojë në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit Konventën e Formimit në Hagë të 1964-ës duke njoftuar qeverinë ë Hollandës për këtë efekt.

6. Për qëllime të këtij neni, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi në lidhje me këtë Konventë nga shtetet palë të Konventës së Formimit në Hagë të 1964-ës ose të Konventës së Shitjeve në Hagë të 1964-ës nuk do të jenë efektive deri sa këto denoncime të bëhen vetë efektive, siç mund të kërkohen nga ana e atyre shteteve në lidhje me këto dy konventat e fundit. I autorizuari i kësaj Konvente do të konsultohet me qeverinë e Hollandës, si i autorizuari i konventave të 1964-ës, për të siguruar koordinimin e nevojshëm për këtë çështje.

Neni 100

1. Kjo Konventë zbatohet për hartimin e kontratave vetëm kur propozimi për lidhjen e kontratës është bërë ose pas datës kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me shtetet kontraktuese të përmendura në nënparagrafin (1) (a) ose me shtetet kontraktuese referuar në nënparagrafin (1) (b) të nenit 1.

2. Kjo Konventë zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose pas datës kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me shtetet kontraktuese referuar në nënparagrafin (1) (a) ose shtetet kontraktuese referuar në nënparagrafin (1) (b) të nenit 1.

Neni 101

1. Një shtet kontraktues mund ta denoncojë këtë Konventë, ose pjesën II ose pjesën III të kësaj Konvente, nëpërmjet një njoftimi formal me shkrim drejtuar të autorizuarit.

2. Denoncimi merr efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të afatit prej dymbëdhjetë muajsh, pas marrjes së njoftimit nga i autorizuari. Kur në njoftim specifikohet një periudhë më e gjatë për denoncimin që të marrë efekt, denoncimi merr efekt me përfundimin e kësaj periudhe më të gjatë pas marrjes së njoftimit nga i autorizuari.

Bërë në Vjenë, këtë ditë të 11 prill-it, një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë, në një origjinal të vetëm, nga i cili tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë autentike.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e nënshkruar, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.